



Pranuar / Dërguar Prilijeno/Prilato Received/Delivery	29.11.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jedinstvo Org. /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojça Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	7483/2022		1/3

Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr. 920/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi –Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 920/2022 të datës 14.10.2022, të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike “ kompensim material”, duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 25.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A. nr. 920/2022 të datës 14.10.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Gjakovës sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me numër protokollit 01N.112/02-18582 të datës 12.07.2021 në pozitën „Drejtor në Shkollën Mazllum Këpuska” në Gjakovë, përmes përfaqësuesit të tij Avokat përmes postës më datë 12.10.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 14.10.2022 dhe është regjistruar nën shenjë A.nr.920/2022 me Nr. Prot:6205/2022 me pretendimet ankimore, lidhur me kompensimin e shpenzimeve për ushqim, për përudhen nga data 31.08.2020, deri me datën 31.05.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike ,për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër A. Nr. 920/2022 të datës 14.10.2022 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i datës 20.08.2021; Kërkesë e datës 18.05.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 05.08.2022;Vendimi i datës 28.09.2022, me numër protokollit 01-070/01-21211, i Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik; Vërtetim i datës 22.06.2021; Përgjigje në ankesë e datës 04.11.2022, me numër protokollit 6736/2022, me shkresat e bashkangjitur; Vendimi i Kryetarit të Komunës së Gjakovës me numër protokollit 01Nr.112/02-18582 i datës 12.07.2021 për emërimin e ankuesit në pozitën Drejtor në Shkollën „ Mazllum Këpuska” në Gjakovë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të provave të lëndës, ka konstatuar që Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit, *sepse*:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i'u referuar provave të lëndës, konstaton se ankuesi është në marrëdhënie punë në Komunën e Gjakovës respektivisht nga administrimi i provave materiale rrjedhë së ankuesi ka qene i emëruar sipas Vendimit të Kryetarit të Komunës së Gjakovës me numër protokollit 01Nr.112/02-18582 të datës 12.07.2021 në pozitën „Drejtor në Shkollën Mazllum Këpuska” në Gjakovë.

Duke ju referuar Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht në nenin 2 paragrafin 2 zyrtarët publikë janë kategorizuar në: 2.1. *nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil)*; 2.2. *nëpunësi i Shërbimit Publik*; 2.3. *nëpunësi i Kabinetit*; dhe 2.4. *nëpunësi administrativ dhe mbështetës*, bazuar në këtë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të Institucioneve Arsimore të Kosovës kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, siç parashihet me nenin 2 paragrafin 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, mbi këtë bazë pozita që mban ankuesi „Drejtor në Shkollën Mazllum Këpuska” në Gjakovë nuk hyn në kategorinë e nëpunësve civil.*

Ndërlidhur me këtë pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka trajtuar në mënyrë të detajuar marrëdhënien e punës së nëpunësve të shërbimit publik, mbi këtë bazë dhe duke ju referuar dispozitave të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, meqenëse ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, atëherë udhëzon palën për ushtrimin e mjeteve juridike sipas nenit 24 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *“Nëpunësi i*



*Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente”.*

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**  
**Lënda me numër Nr. A. nr.920/2022**

**Rushit KAJTAZI**

**Procesmbajtës**

**Malsore GASHI - BAJRAKTARI**

**Kryetare e Kolegjit**

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- Drejtorit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Gjakovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Gjakovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së